- che sia consentito al presidente dell'assemblea di accertare l'identità e la legittimazione degli intervenuti, regolare lo svolgimento dell'adunanza, constatare e proclamare i risultati della votazione;

- che sia consentito al soggetto verbalizzante di percepire adeguatamente gli eventi assembleari oggetto di verbalizzazione;

- che sia consentito agli intervenuti di partecipare alla discussione ed alla votazione simultanea sugli argomenti all'ordine del giorno, nonché di visionare, ricevere o trasmettere documenti;

- che siano indicati nell'avviso di convocazione i luoghi collegati con l'ausilio di mezzi di telecomunicazione a cura della società, nei quali gli intervenuti potranno affluire, dovendosi ritenere svolta la riunione nel luogo ove saranno pre-



sentì il presidente e il soggetto verbalizzante.

Articolo 17

L'assemblea degli azionisti può essere ordinaria e straordinaria secondo la legge.

L'assemblea ordinaria è regolarmente costituita in prima convocazione con l'intervento di tanti soci che rappresentino più della metà del capitale sociale, escluse dal computo le azioni prive del diritto di voto nell'assemblea medesima. Essa delibera a maggioranza assoluta del capitale rappresentato in assemblea.

L'assemblea ordinaria in seconda convocazione delibera a maggioranza assoluta sugli oggetti che avrebbero dovuto essere trattati nella prima, qualunque sia la parte di capitale rappresentata dai soci intervenuti.

Per le deliberazioni riguardanti la forma dell'organo amministrativo è necessario il voto favorevole di tanti soci che rappresentino almeno il settanta per cento del capitale sociale.


Per le deliberazioni relative alla nomina del consiglio di amministrazione della società, in mancanza di acclamazione unanime, valgono i seguenti criteri: le nomine dei consiglieri di amministrazione devono essere adottate a maggioranza semplice sulla base di liste presentate dai soci, nelle quali i candidati saranno elencati in ordine progressivo; ciascun socio avrà diritto a votare per una sola lista; si assegnerà quindi

a ciascun componente di lista il voto ottenuto dalla lista stessa, diviso successivamente per uno, due e tre, ed eventualmente quattro e cinque a seconda del numero di membri da eleggere; saranno eletti coloro che, in qualunque lista si trovino, avranno ottenuto i quozienti più elevati, considerando per ciascun candidato che risulti inserito in più liste solo il maggior quoziente conseguito fra tutte, esclusa quindi la possibilità di sommare i quozienti ottenuti da uno stesso candidato in liste diverse; a parità di quoziente per gli ultimi da eleggere, si intenderanno eletti i candidati collocati nella posizione più elevata all'interno delle relative liste, e in caso di ulteriore parità risulterà eletto il più anziano di età.

In caso di decadenza di un consigliere di amministrazione dalla carica, per dimissioni, revoca o qualsiasi altra causa, si dovranno intendere necessariamente decaduti anche tutti gli altri amministratori, e si dovrà procedere ad una nuova nomina dell'intero organo amministrativo.

L'assemblea straordinaria, in prima convocazione, è regolarmente costituita e delibera con il voto favorevole di tanti soci che rappresentino più dell'ottanta per cento del capitale sociale; in seconda convocazione si costituisce e delibera con il voto favorevole di tanti soci che rappresentino più del settanta per cento del capitale sociale.

Se esistono diverse categorie di azioni le deliberazioni del-



l'assemblea che pregiudichino i diritti di una di esse, devono essere approvate anche dall'assemblea speciale dei soci della categoria interessata.

Alle assemblee speciali si applicano le disposizioni relative alle assemblee straordinarie.

L'assemblea ordinaria deve essere convocata almeno una volta all'anno entro 120 (centoventi) giorni dalla chiusura dell'esercizio sociale ed entro 180 (centoottanta) giorni, quando lo richiedono particolari esigenze relative alla struttura e all'oggetto della società'.

Articolo 18

Ogni socio che abbia diritto di intervenire in assemblea può farsi rappresentare anche da soggetto non socio nel rispetto dell'art. 2372 del C.C., per delega scritta, che deve essere conservata dalla società; non può essere rilasciata con il nome del delegato in bianco ed è sempre revocabile, nonostante ogni patto contrario.

Se la delega viene conferita per la singola assemblea, essa ha effetto anche per la seconda convocazione.

E' ammessa anche una delega a valere per più assemblee, indipendentemente dal loro ordine del giorno.

TITOLO V: AMMINISTRAZIONE

Articolo 19

La società può essere amministrata, alternativamente e su decisione dei soci in sede di nomina, nel rispetto del *quorum* di

cui al quarto comma dell'art. 17 che precede:

a. da un amministratore unico;

b. da un consiglio di amministrazione composto da un minimo di tre ad un massimo di cinque membri, secondo il numero determinato dai soci al momento della nomina.

Per organo amministrativo si intende l'amministratore unico, oppure il consiglio di amministrazione.

Possono essere eletti amministratori anche coloro che non siano soci della società.


La nomina degli amministratori spetta all'assemblea ordinaria, salvo i primi che sono nominati nell'atto costitutivo.

Gli amministratori sono rieleggibili, e durano in carica per il periodo fissato dall'assemblea che li nomina, comunque non superiore a tre esercizi.

Il consiglio di amministrazione, se non vi abbia già provveduto l'assemblea dei soci, elegge tra i suoi componenti il presidente.

Il consiglio di amministrazione si riunisce nel luogo indicato nell'avviso di convocazione, sia nella sede sociale o altrove, purché in Italia, su convocazione del presidente, anche a seguito di richiesta da parte di uno dei suoi membri o di un sindaco.

La convocazione, contenente gli argomenti da trattare, sarà fatta a mezzo lettera raccomandata o telegramma o telefax o posta elettronica spediti almeno cinque giorni prima dell'a-



dunanza e, nei casi di urgenza, con telegramma o telefax o posta elettronica inviati almeno due giorni prima al domicilio di ciascun consigliere e sindaco. Il telefax andrà inviato al numero comunicato dagli amministratori e sindaci alla società o, se la convocazione avviene a mezzo posta elettronica, all'indirizzo e-mail dagli stessi indicato.

Tale formalità non è necessaria se sono presenti tutti i membri del consiglio di amministrazione e tutti i membri effettivi del collegio sindacale.

La riunione è presieduta dal presidente del consiglio di amministrazione, il quale nomina un segretario; questi redige il verbale della riunione, che deve essere sottoscritto da lui e dal presidente.

Le deliberazioni del consiglio saranno valide quando sia presente la maggioranza dei consiglieri e saranno prese a maggioranza assoluta dei voti.

In caso di parità di voti, la proposta di delibera si intenderà respinta.

Le riunioni del consiglio di amministrazione si possono svolgere anche mediante mezzi di telecomunicazione, sussistendo le condizioni stabilite al precedente art. 16 per le assemblee dei soci.

Articolo 20

L'organo amministrativo è investito di tutti i poteri per l'amministrazione della società ed ha facoltà di compiere tut-

ti gli atti che ritiene opportuni per l'attuazione ed il raggiungimento degli scopi sociali, esclusi quelli che la legge o il presente statuto riservano all'assemblea.

In sede di nomina possono tuttavia essere determinati limiti ai poteri degli amministratori.

All'amministratore unico, ai componenti del consiglio di amministrazione o ai singoli amministratori, oltre al rimborso delle spese effettivamente sostenute per ragioni del loro ufficio, potrà essere riconosciuto dall'assemblea dei soci un compenso annuo per l'opera svolta, anche sotto forma di partecipazione agli utili, nonché una indennità di fine rapporto.


L'organo amministrativo può conferire procure speciali a persone anche estranee alla società per l'esecuzione di singoli atti. I limiti e le attribuzioni inclusi nella procura dovranno essere espressamente indicati nella medesima.

Il consiglio di amministrazione può delegare le proprie attribuzioni ad un comitato esecutivo formato da due o più dei suoi membri, o ad uno o più dei suoi membri, indicando in ogni caso espressamente i limiti ed i poteri attribuiti con la delega.

Il consiglio di amministrazione può altresì attribuire incarichi speciali ai propri membri, determinandone i relativi compensi.

Articolo 21

La rappresentanza della società spetta all'amministratore uni-



co, ovvero al presidente del consiglio di amministrazione, ovvero ai singoli consiglieri o procuratori per gli atti compiuti nei limiti dei poteri eventualmente ad essi attribuiti dall'organo amministrativo.

TITOLO VI: COLLEGIO SINDACALE

Articolo 22

Il collegio sindacale si compone di tre membri effettivi e di due supplenti, nominati per la prima volta nell'atto costitutivo e successivamente dall'assemblea ordinaria dei soci, che durano in carica tre esercizi e sono rieleggibili. Il presidente è nominato dall'assemblea dei soci, con la decisione di nomina del collegio stesso.

Il collegio sindacale ha i doveri ed i poteri di cui agli articoli 2403 e 2403 bis del Codice Civile ed esercita il controllo contabile, ove la società non sia tenuta alla redazione del bilancio consolidato. In tal caso tutti i sindaci devono essere revisori contabili iscritti nell'apposito registro istituito presso il Ministero della Giustizia.

Nell'ipotesi in cui la società sia tenuta alla redazione del bilancio consolidato il controllo contabile è esercitato dai soggetti indicati dall'articolo 2409 bis del Codice Civile, con i doveri e poteri di cui all'articolo 2409 ter.

Ai sindaci spettano i compensi previsti dalle rispettive tariffe professionali; ai membri scelti tra i professori universitari di ruolo in materie economico o giuridiche spettano i

compensi previsti per la carica dalla tariffa professionale
dei Dottori Commercialisti.

TITOLO VII: BILANCIO E UTILI

Articolo 23

Gli esercizi sociali si chiudono il 31 dicembre di ogni anno.
Entro i termini e con le forme di legge, l'organo amministrativo provvederà alla compilazione del bilancio di esercizio costituito dallo stato patrimoniale, dal conto economico e dalla nota integrativa, corredandolo con una relazione sulla situazione della società e sull'andamento della gestione, in quanto dovuta.

Gli utili netti risultanti dal bilancio, dedotto almeno il cinque per cento da destinare a riserva legale fino a che questa non abbia raggiunto il quinto del capitale, verranno ripartiti tra i soci in misura proporzionale alla partecipazione da ciascuno posseduta, salvo diversa decisione dei soci.


TITOLO VIII: SCIoglIMENTO E LIQUIDAZIONE; NORME GENERALI

Articolo 24

Addivenendosi in qualsiasi tempo e per qualsiasi causa allo scioglimento della società, l'assemblea straordinaria stabilirà le modalità della liquidazione e nominerà uno o più liquidatori, determinandone poteri e compensi, nel rispetto del precedente articolo 12.

Articolo 25

Tutte le controversie tra soci, tra soci e società, nonché



quelle promosse da e nei confronti di amministratori, liquidatori e sindaci, comunque relative al rapporto sociale, saranno risolte in via definitiva in conformità al Regolamento di Mediazione/Arbitrato di Curia Mercatorum. Il tribunale arbitrale sarà integralmente nominato dalla Corte per la risoluzione delle controversie di Curia Mercatorum.

Articolo 26

Per quanto non è espressamente contemplato nel presente statuto, si fa riferimento alle disposizioni contenute nel Codice Civile in materia di società per azioni.



Treviso, li 18 (diciotto) dicembre 2003 (duemilatre)

F.to Annibale Franco

F.to Umberto Cosmo - Notaio I.S.

COPIA AUTENTICA CONFORME ALL'ORIGINALE
ESISTENTE NEI MIEI ROGITI CHE RILASCIO

in conto l'ora per gli usi consentiti dalla Legge -
TREVISO, LI 13 maggio 2004.



STATUTI I SHOQERISE ME AKSIONE
"AMA S.H.A "



KREU I: EMËRTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

Neni 1

Është themeluar një shoqëri me aksione me sistemin e administrimit dhe kontrollit, sipas Kapitullit V° Kreu V° Libri V° - Seksioni VI-bis, paragrafët II, III dhe IV të Kodit Civil, me oferte private, e quajtur:

"AMA S.H.A"

Neni 2

Shoqëria e ka selinë ligjore në **Casale sul Sile (TV)** (Cazale sul Sile, *shënim i përkthyesit*)*. Mund të krijohen ose të mbyllen seli dytësore; si në Itali dhe jashtë saj, agjenci, degë, filiale dhe zyra përfaqësimi.

Adresa ligjore e secilit ortak për marrëdhëniet me shoqërinë është ajo që tregohet në regjistrin e ortakëve.

Neni 3

Shoqëria ka për objekt të shoqërisë, në përputhje me ligjet në fuqi, kryerjen e aktiviteteve të mëposhtme:


- ndërtimin dhe tregtimin e serbatoreve, kontejnerëve dhe furnizuesve të karburanteve dhe lëngjeve në përgjithësi, kontejnerë të pajisur, gjithashtu edhe për përdorim në banesa, serbatore për përdorime të veçanta, pajisje, impiante dhe makineri të ngjashme dhe të ndërlydhura, edhe në kontejnerë dhe në pajisje me rrota, autobote dhe rimorkio të pajisur për transport, shpërndarje dhe trajtim të karburanteve dhe lëngjeve në përgjithësi, gjithashtu të kompletuara me njësi transferimi, filtrimin dhe shpërndarjen e këtyre lëngjeve, kontejnerë për ruajtjen dhe transportin e materialeve të ngurta dhe të kokrrizuara, karburante dhe lëngje në përgjithësi si dhe pajisje elektromekanike dhe elektronike të lidhura me këto;

- instalimin, riparimin, mirëmbajtjen, furnizimin dhe vënien në punë të impianteve dhe depozitave për karburantet dhe lëngjet në përgjithësi, përfshirë edhe realizimin e impianteve elektrike, mekanike (hidraulike) dhe të mbrojtjes nga zjarri, të lidhura me realizimin e këtyre impianteve;

- marrja me qira e mallrave të treguar më lart;
- ndërtimin, riparimin, mirëmbajtjen dhe tregtimin e aksesorëve të mallrave të treguara më lart.

Shoqëria, gjithashtu, mund:

- të kryejë, në mënyrë jo mbizotëruese dhe mjaft rastësore, çdo transaksion tregtar, industrial dhe financiar, me kusht që të mos kryhet kundërsht publikut, veprimtari në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, që do të konsiderohet i nevojshëm dhe/ose i dobishëm, për arritjen e qëllimit të objektit të shoqërisë;



- promovimin dhe zhvillimin e nismave me karakter shoqëror, përmes veprimtarisë, jo të ushtruar kundrejt publikut, të marrjes së interesave dhe aksioneve në shoqëri ose ente të çfarëdo lloji, kombëtare ose të huaja, të cilat kanë objekt të ngjashëm ose të përafërt me të vetin, e në çdo rast në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

E gjitha në përputhje me Dekretin Legjislativ Nr. 385/1993 dhe të Ligjit n. 1/1991, si dhe te dispozitave të tjera pasuese të çështjeve bankare dhe kreditore.

- Marrja e aksioneve që përfshijnë një përgjegjësi të pakufizuar, duhet të vendoset nga asambleja e zakonshme e ortakëve.

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar deri më 31 dhjetor 2030 (tridhjetë e një dhjetor dy mijë e tridhjetë); shoqëria mund të zgjasë ose të shpërndahet paraprakisht, me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve.

KREU II: KAPITALI I SHOQËRISË, AKSIONE. OBLIGACIONE

Neni 5

Kapitali aksionar është vendosur në 500.000,00 (pesëqind mijë/00) Euro e ndarë në 500.000 (pesëqind mijë) aksione me një vlerë nominale prej 1 (një) Euro secila.

Aksionet përfaqësohen nga letrat me vlerë.

Kapitali aksionar duhet të jepet me para të gatshme. Në përputhje me vendimin e asamblesë së ortakëve, mund të jepet gjithashtu, në natyrë ose përmes kontributeve të kreditit, në këto raste, dhënësi duhet të paraqesë një raport vlerësimi në përputhje me nenin 2343 të Kodit Civil.

Secilit ortak i është caktuar numri i aksioneve në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të nënshkruar dhe për një vlerë që nuk e tejkalon atë të kontributit të vet.

Neni 6

Aksionet janë nominative; secila prej tyre atribuon të drejtën për një votë.

Në rastin e bashkëpronarëve, të drejtat e bashkëpronarëve duhet të ushtrohen nga një përfaqësues i përbashkët.

Shoqëria mund të lëshojë, në përputhje me vendimin e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve, kategori aksionesh të pajisura me të drejta të ndryshme, në përputhje me nenet 2348, 2349, 2350 dhe 2351 të Kodit Civil.

Aksionet me vote të kufizuar nuk mund të kenë një vlerë totale që tejkalon gjysmën e kapitalit aksionar.

Neni 7

Asambleja e ortakëve mund të vendosë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë edhe me emetimin e aksioneve që kanë të drejta të ndryshme nga ato që janë në qarkullim, në përputhje me dispozitat e ligjit për këtë çështje.

Aksionet e lëshuara rishtazi duhet t'u ofrohen si opsion ortakëve në përpjesëtim me numrin e aksioneve në posedim të secilit, përveç parashikimeve të paragrafit të katërt dhe të pestë të nenit 2441 i Kodit Civil.



I takon organit administrativ e drejta të rrisë kapitalin aksionar falas ose me pagesë, një ose më shumë herë, për periudhën maksimale të vendosur nga neni 2443 i Kodit Civil, pa e tejkaluar kufirin maksimal të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë prej 2.000.000,00 Euro (dy milion / 00).

Neni 8

Nëse një ortak synon të shesë të gjitha ose një pjesë të aksioneve të veta dhe/ose të drejtat e opsionit që i takojnë atij në rast të operacioneve të zmadhimit të kapitalit, ai duhet të komunikojë atë duke treguar subjektin tek i cili synon të transferojë aksionet dhe / ose të drejtat e opsionit, si dhe sasinë e tyre, vlerën e rënë dakord dhe kushtet e pagesës - me letër rekomande me dëftesë kthimi, organit administrativ, për qëllime të ushtrimit të së drejtës së parablerjes të përcaktuara më poshtë. Dispozitat e përcaktuara në këtë nen vlejnë si në hipotezën e transferimit të së drejtave të pronësisë, ashtu edhe për transferimin e të drejtave të tjera reale.

Ne transferimet, për të cilat aplikohet e drejta e parablerjes, e parashikuar në këtë nen, përfshihen edhe të gjitha transaksionet *inter vivos* (nder të gjallët, sh.i.p)*, që në çdo rast sjell transferimin në një tjetër subjekt të aksioneve dhe / ose të drejtave të opsionit, siç janë shkëmbimi, *datio in solutum* (shërbim në vend të përmbushjes, sh.i.p)*, dhënia, transferimi i kontrollit të një shoqërie ortake, bashkimi ose ndarja e saj, si dhe dhurimet dhe akte të tjera me përmbajtje liberale; në të gjitha këto raste, ortaku që ka ndërmend të transferojë aksionet dhe / ose të drejtat e opsionit, duhet të tregojë në aktin e ofertës, në vend të çmimit të shitjes të cituar më lart, vlerën që u atribuohet atyre, ndërsa afati i pagesës për parablerje të mundshme do të jetë gjashtëdhjetë ditë nga data e aktit të transferimit të po të njëjtët, efektiviteti i së cilës do të kushtëzohet domosdoshmërisht me përfundimin e plotë të kësaj pagese.

Nuk do t'i nënshtrohen kufizimeve të treguara në këtë nen transferimet e bëra në çdo formë me akt midis të gjallëve, midis të afërmeve në linjë të drejtpërdrejtë të gradës së parë; nuk do të kenë kufizime gjithashtu, transferimet e aksioneve në administrim besimi të bëra nga një ortak të shoqëri me natyrë besimi sipas kërkesave të kërkuara nga ligji; gjithashtu do të jenë lirisht të transferueshme aksionet dhe / ose të drejtat e opsionit nga një shoqëri të një tjetër e kontrolluar ose mëmë ose që i nënshtrohet kontrollit të së njëjtës shoqëri, si dhe nga një shoqëri tek një ortak i saj me shumicë absolute dhe anasjelltas.

Brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e letrës rekomande që përmban shprehjen e vullnetit për transferimin e aksioneve dhe/ose të drejtave të opsionit, organi administrativ, edhe me letër rekomande me lajmërim marrje, duhet të njoftojë ortakët, në vendbanimin që rezultojnë nga regjistri i ortakëve, për ofertën që përmban të gjitha indikacionet e mësipërme.

Ortakët që marrin këtë komunikim do të kenë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për blerjen e aksioneve dhe /ose të drejtat e opsionit, të cilave i referohet komunikimi, në mënyrat dhe kushtet e mëposhtme:

a) secili ortak i interesuar për blerjen duhet t'i dërgojë organit administrativ deklaratën e ushtrimit të parablerjes me letër rekomande me lajmërim marrje, e cila duhet të dërgohet jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e marrjes së ofertës së parablerjes:

b) nëse asnjë ortak nuk ka shprehur qëllimin e tij për të ushtruar parablerjen në format e treguara më lart, e në çdo rast siç parashikohet në shkronjën d), si dhe në çdo rast tjetër në të



cilin oferta do të konsiderohet se nuk pranohet në përputhje me parashikimet e përcaktuara më poshtë, ortakut ofertues do të jetë i lire të shesë ose në çdo rast të transferojë aksionet e veta dhe/ose te drejtat e opsionit, subjektit dhe me kushtet të treguara ne ofertë, me kusht që transferimi të bëhet jo më vonë se nëntëdhjetë ditë nga data në të cilën është saktësuar mospranimi i vetë ofertës:

c) në rast se parablerja mund të ushtrohet nga më shumë se një ortak, aksionet dhe/ose të drejtat e opsionit, të ofruara do t'ju takojnë secilit prej ortakëve të interesuar në proporcion me numrin e aksioneve të mbajtura, përveç shortit midis tyre për kuotat, të cilat për qëllimin e shpërndarjes nuk do të jetë e mundur t'i caktohen plotësisht secilës palë të interesuar;

Në rast të mos ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga një ose më shumë ortakëve, organi administrativ, brenda dhjetë ditëve nga skadimi i afatit të caktuar për ortakët për ushtrimin e së drejtës së parablerjes, duhet t'ju komunikojë këte me letër rekomande me lajmërim marrje, të gjithë atyre ortakëve që kanë ushtruar të drejtën e parablerjes, në mënyrë që ata të mund të ushtrojnë, mbi këto aksione dhe /ose te drejta te opsionit që janë akoma në dispozicion, rritjen e parablerjes përkatëse, ne dhjete ditët pasuese nga data e marrjes se komunikimit; në rast se me shume se nje ortak shpreh vullnetin për te rritur te drejtën e tij te parablerjes mbi aksionet dhe / ose të drejtat e opsionit të disponueshëm, do të bëhet një ndarje midis palëve të interesuara në proporcion me numrin e aksioneve të mbajtura nga secila respektivisht, përveç shortit mes tyre për aksionet që do të ishte e pamundur të caktoheshin plotësisht për secilën palë të interesuar; nëse e drejta e rritjes siç rregullohet më lart nuk ushtrohet plotësisht dhe në çdo rast ne te cilin e drejta e parablerjes nuk ushtrohet për tërë sasinë e aksioneve dhe / ose të drejtat e opsionit të treguar nga ofertuesi, oferta do të konsiderohet se nuk pranohet dhe do te zbatohet sa është përcaktuar në pikën b); ne rast kur ne te kundert, parablerja do të jetë perfeksionuar, transferimi i aksioneve dhe / ose të drejtave të opsionit në favor të para blerësve dhe me kete edhe kalimi i afateve të pagesës të treguara në ofertë, duhet të bëhet - në kushtet e treguara nga ofertuesi - brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data në të cilën parablerja do të përfundojë;

d) e gjithë procedura e parablerjes, siç tregohet me lart, do te pezullohet ne rast se një ose më shumë ortakë do te kontestojnë përputhshmërinë e ekuivalentit ose vlerës së treguar në ofertë, me letër rekomande me lajmërim marrje, qe do t'ju dërgohet, jo me vone se tridhjete dite nga data e marrjes se ofertës se parablerjes, organit administrativ dhe ortakut ofertues; ne kete rast do të vendoset një procedurë arbitrazhi, qe synon vlerësimin e drejtë të vlerës së aksioneve dhe/ose te drejtat e opsionit te ofruara; ky arbitrazh do të shpjegojë efektet kundrejt ortakëve që kanë bërë kërkesë dhe ofertuesit dhe do të zhvillohet sipas procedurave dhe modaliteteve te përshkruara në nenin 9 më poshtë; nëse vlera e përcaktuar ne përfundim te arbitrazhit do te rezultojë me e larte se ajo e treguar ne oferte, transferimi i mundshëm ne favor te para blerësve qe kane kërkuar arbitrazhin, do te behet sidoqoftë me kushtet e përcaktuara fillimisht, ndërsa nëse do te rezultojë me e ulet, transferimi i mundshëm do të bëhet kundrejt tyre, ne vlerën e përcaktuar nga arbitrat; mbetet i pandryshuar, gjithsesi dhe ne çdo rast, e drejta për kërkesit e arbitrazhit, për të ushtruar ose jo të drejtën parablerjes, brenda dhjetë ditësh nga marrja e komunikimit të rezultatit të vetë arbitrazhit, duke interpretuar heshijen e tyre - pas afatit - si refuzim te ushtrimit;

Nëse vlera e përcaktuar nga arbitrat do të jete me e ulet se mbi 20% në krahasim me ofertën, ofertuesi do të ketë të drejtë të tërheqë të gjithë ofertën dhe të mbajë aksionet dhe / ose të



drejtat e opsionit duke bere njoftim nëpërmjet letër rekomande me lajmërim marrje te gjithë para blerësve dhe organit administrativ brenda dhjete ditëve nga marrja e komunikimit i rezultatit te arbitrazhit, kostoja e të cilit në këtë rast do të jetë plotësisht në ngarkim të tij. Në raste të tjera kostoja e procedurës së arbitrazhit do të jete plotësisht ne ngarkim te ofertuesit, nëse rezultati do të jetë 20% më i ulët ne krahasim me ofertën dhe do te përmbillet ushtrimi i parablerjes, do të jete plotësisht ne ngarkim vetem te para blerësve që kanë bërë kërkesën, nëse rezultati do të jetë i barabartë ose më i lartë se oferta dhe në të gjitha rastet e tjera, do të ndahet në pjesë të barabarta ndërmjet para blerësve që kane bërë kërkesën, solidarisht ndërmjet tyre dhe ofertuesit; pasi të ketë përfunduar faza e arbitrazhit, pasi kane kaluar dhjetë ditëve pas marrjes së komunikimit të rezultatit të saj nga të gjithë kërkuessit dhe ofertuesit, procedura e parablerjes do të rifillojë siç parashikohet më sipër dhe me të edhe skadimi i afateve të treguara në të; rritjet e përmendura në shkronjën c) më lart do të bëhen me të njëjtat çmime për secilin para blerës në baze të dispozitave të mësipërme.

Neni 9

Në rast të vdekjes së një ortaku, ortakët e mbijetuar, do të vendosin unanimisht nëse do të pranojnë hyrjen ne shoqëri te trashëgimtareve, te cilët duhet të emërojnë një përfaqësues të përbashkët, ose të marrin përsipër - nga një ose më shumë prej tyre ose ekskluzivisht ne ngarkim te tyre - pjesëmarrjen e ortakut të ndjerë duke u likuiduar në këtë rast, trashëgimtarëve, brenda gjashtë muajve dhe pa paguar interes, vlerën e pjesëmarrjes, që do t'u propozohet po te njëjtëve, mbi bazën e bilancit në vlerat aktuale referuar në datën e vdekjes.

Organi administrativ, brenda nëntëdhjetë ditëve nga vdekja e ortakut, duhet të verifikojë qëllimin e ortakëve të mbijetuar, në baze të sa me sipër eshte përmendur dhe t'ia komunikojë ketë trashëgimtarëve, me letër rekomande me lajmërim marrje; në mungesë të komunikimit trashëgimtarëve brenda afatit të lartpërmendur dhe në çdo rast kur ortakët e mbijetuar nuk arrijnë ne ndonjë vendim unanimit, në zbatim të sa më sipër, trashëgimtarët do të konsiderohen te pranuar ne strukturën e shoqërisë, në mënyrë te heshtur dhe duhet që, brenda tridhjetë ditëve të tjera, t'i komunikojnë shoqërisë, emrin e atij qe do të veprojnë si përfaqësues i përbashkët.

Në rast se trashëgimtarët nuk bien dakord mbi vlerësimin e pjesëmarrjes së propozuar, do të bëjnë apel - me kërkesë me shkrim me letër rekomande me lajmërim marrje, që duhet t'i dërgohet organit administrativ nga një ose më shumë prej trashëgimtarëve brenda dhe jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e marrjes se komunikimit te parathënë, me penalitetin, pranimin e heshtur te vlerësimin të propozuar - një kolegji arbitrash të përbërë nga tre anëtarë të zgjedhur nga llogaritarë të autorizuar ose kontabilistë të regjistruar në regjistrat profesional përkatës, nga të cilët emërohen dy - një nga secili - nga trashëgimtarët, nga njëra anë dhe nga ortakët e mbijetuar që synojnë të marrin kuotën nga ana tjetër.

Ky arbitrazh do te lere mënjanë çdo formalitet procedural dhe rregullat e ligjit.

Në rast të neglizhencës së njëres nga palët në emërimin e arbitrit të tij pas pesëmbëdhjetë ditësh nga marrja e kërkesës për arbitrazh, arbitri do të caktohet, me kërkesë të palës më të zellshme, nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit në të cilin shoqëria ka selinë.



- Arbitri i tretë, i cili do të veprojë si presidentit i kolegjit, do të emërohet - brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga emërimi i arbitrit të dytë - nga dy te paret te caktuar si me lart. Pasi të përfundojë afati i mësipërm i mosmarrëveshjes, arbitri i tretë do të emërohet, me kërkesë të arbitrit më të zellshëm, nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit, në të cilin ka selinë shoqëria.

Kolegji i formuar në këtë mënyrë do të kryejë detyrën me përcaktim përfundimtar, duke marrë parasysh pozicionin financiar të shoqërisë, përfitimin e saj, përfshirë mundësinë e pozicionit të saj në treg dhe çdo kusht dhe rrethanë tjetër që normalisht ndikon në vlerësimin e një pjesëmarrjeje në shoqëri.

Kolegji i arbitrave duhet t'u komunikojë palëve përcaktimin e vlerës së kuotës, brenda dhe jo më vonë se nëntëdhjetë ditë nga themelimi i tij, përveç rasteve të shtyrjes, për të cilën është rënë dakord me shkrim nga palët që gjithashtu do të vendosin për kostot dhe humbjen e tyre. Kur trashëgimtarët janë të gjithë të afërm të linjës së parë me ortakun e ndjerë dhe të paktën njëri prej tyre është në moshë madhore, ata hyjnë automatikisht në strukturën e shoqërisë, duke qenë se ortakëve nuk u takon ndonjë vendim tjetër i ndryshëm.

Neni 10

Shoqëria mund të emetojë kredi të obligacioneve të konvertueshme dhe jo të konvertueshme. Emetimi i obligacioneve jo të konvertueshme vendoset nga organi administrativ me një procesverbal të hartuar nga një noter.

I atribuohet organit administrativ, e drejta për të emetuar obligacione të konvertueshme në aksione, një ose më shumë herë, për periudhën maksimale të vendosur nga neni 2420-ter i Kodit Civil, brenda kufirit maksimal prej 1.000.000,00 Euro (një milion / 00).

Obligacionet e çdo natyre duhet të ofrohen si opSION për ortakëve në përpjesëtim me numrin e aksioneve në posedim të secilit.

Asambleja e zotëruesve të obligacioneve duhet të caktojë një përfaqësues të përbashkët.

Asamblesë së zotëruesve të obligacioneve u aplikohen, pasi në përputhje, dispozitat që kanë lidhje me asamblesë së jashtëzakonshme.

Neni 11

Me vendim konform të ortakëve dhe pa modifikim të kapitalit aksionar, ortakët mund të bëjnë dredhje në llogarinë kapital në favor të shoqërisë, si dhe financime si hua, në përputhje me kufijtë dhe kushtet e përcaktuara nga rregulloret aktuale për këtë çështje dhe gjithashtu në masë jo proporcionale me kontributet ose pjesëmarrjet përkatëse;

Financimet duhet të kuptohen pa interes, përveç nëse parashikohet ndryshe me vendimin të ortakëve të lartpërmendur.

KREU IV: ASAMBLEJA

Neni 12

Asambleja e zakonshme e ortakëve vendos për çështjet e rezervuara për të me ligj dhe me këtë statut.

I rezervohen detyrimisht kompetencës së asamblesë së zakonshme :

- a. miratimi i bilancit;
- b. emërimi dhe revokimi i administratoreve dhe struktura e organit administrativ;



- c. emërimi dhe revokimi i auditorëve dhe kryetarit të kolegjit të auditorëve ligjorë e kur parashikohet, për personin të cilit i është besuar kontrolli kontabël;
- d. përcaktimi i shpërblimit të administratorëve;
- e. vendimin për përgjegjësinë e administratoreve dhe të auditorëve;

Neni 13

Jane kompetence e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakeve :

- a. ndryshimet në statut;
- b. emërimi, zëvendësimi dhe përcaktimi i kompetencave të likuiduesve;
- c. çështjet e tjera që i atribuohen me ligj dhe nga ky statut.

Neni 14

Kane të drejte të ndërhyjnë në asamble ortaket, të cilëve u takon e drejta e votës.

Ortakët, të cilët synojnë të marrin pjesë në asamble, edhe për qëllimet e detyrimeve të përmendura në paragrafin e tretë të nenit 2370 i Kodit Civil, duhet të ekspozojë aksionet në mënyrë që të demonstrojnë legjitimitetin për të marrë pjesë dhe votuar në asamble. Nuk kërkohet paraprakisht depozitimi i aksioneve.

Lejohet ndërhyrja në asamble nëpërmjet mjeteve të komunikimit, përveç siç përcaktohet në nenin vijues 16. Votimi me korrespondencë nuk lejohet.

Neni 15

Asambleja duhet të thirret nga organi administrativ edhe jashtë selisë së shoqërisë me kusht që të jete në Itali.

Në rast të pamundësisë së të gjithë administratorëve ose të mosveprimit të tyre, asambleja mund të thirret nga kolegji i auditorëve ligjorë, ose me kërkesë të shumë ortakëve që përfaqësojnë të paktën një të dhjetën e kapitalit aksionar dhe në kërkesë duhet të tregohen temat që do të trajtohen.

Asambleja thirret me një njoftim që u komunikohet ortakëve, administratoreve dhe auditorëve ligjorë, me letër rekomande me lajmërim marrje, ose me korrier ekspres, dërguar atyre që kanë të drejta në adresën që rezulton në librat e shoqërisë, të paktën tete ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.

Posta elektronike ose telefaksi, mund të zëvendësojë letrën rekomande me lajmërim marrje ose korrierin ekspres, me kusht që mjetet e përmendura të garantojnë provën që dëshmon marrjen brenda afatit të përcaktuar në periudhën e mëparshme. Në këtë rast, njoftimi për mbledhjen do të komunikohet në vendin dhe në adresën e postës elektronike ose në numrin e faksit që i është komunikuar shoqërisë nga ortaket, administratoret dhe auditorët ligjorë. Njoftimi për mbledhjen duhet të tregojë ditën, vendin në të cilin zhvillohet asambleja si dhe vendet të lidhura me të në rrugë elektronike, ora e mbledhjes dhe lista e çështjeve që do të diskutohen.

Në njoftimin e thirrjes, mund të parashikohet një datë e dytë e mbledhjes, nëse mbledhja e mëparshme nuk është konstituuar ligjërisht. Asambleja në thirrjen e dytë duhet të planifikohen me të paktën një ditë interval.

Edhe në mungesë të një thirrje zyrtare, asambleja konsiderohet e konstituuar rregullisht, kur në të përfaqësohet i gjithë kapitali aksionar, merr pjesë shumica e anëtarëve të organit



administrativ dhe te kontrollit dhe askush nuk kundërshton diskutimin e temave pasi nuk konsiderohet sa duhet i informuar. Në këtë rast, duhet t'u komunikohen vendimet e marra anëtarëve të organeve administrative dhe te kontrollit që nuk janë prezent, me letër rekomande me lajmërim marrje, për t'u dërguar nga shoqëria, brenda dhjetë ditëve nga data në të cilën eshte mbajtur mbledhja.

Neni 16

Asambleja kryesohet nga administratori i vetëm, nga presidenti i këshillit te administrimit ose nga administratori më i vjetër në moshë. Në rast të mungesës ose te mos përmbushjes nga ana tyre, asambleja kryesohet nga personi i caktuar nga asambleja me votën e favorshme të shumicës së të pranishmëve.

Kur procesverbali nuk hartohet nga një noter, asambleja emëron një sekretar i cili edhe mund te mos jetë ortak dhe, nëse është e nevojshme, dy vëzhgues të zgjedhur nga të pranishmit.

I takon presidentit te asamblesë të konstatojë kostituimin e rregullt të po së njëjtës dhe respektimin e rregullores, ku parashikohet, të verifikojë identitetin dhe legjitimitetin e te pranishmeve, të drejtojë dhe rregullojë zhvillimin e asamblesë dhe të konstatojë dhe shpallë rezultatet e votimit. Presidenti ka të drejtë të hartojë propozime për vendime dhe për diskutimin e rendit të ditës.

Vendimet e asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbalin e nënshkruar nga presidenti dhe nga sekretari ose nga noteri.


Në veçanti, procesverbali duhet të tregojë:

- a. datën e asamblesë;
- b. identitetin e pjesëmarrësve dhe kapitalin aksionar të përfaqësuar nga secili, edhe përmes një shtojce;
- c. modalitetet dhe rezultatet e votimeve
- d. identitetin e votuesve me specifikimin nëse ata votuan pro, kundër apo abstenuan, edhe nëpërmjet nje shtojce:
- e. me kërkesë te shprehur të të pranishmëve, përmbledhjen e deklaratave të tyre ne lidhje me rendin e ditës.

Asambleja duhet të zhvillohet në atë mënyrë që të gjithë ata që kanë të drejtë të marrin pjesë të jene te vetëdijshëm në kohe reale, për ngjarjet, te formojnë lirshëm bindjen e tyre dhe te shprehin lirshëm votën e tyre. Modalitetet e zhvillimit të asamblesë nuk mund të bien ndesh me nevojat për një regjistrim të saktë dhe të plotë të punimeve.

Asambleja e ortakeve gjithashtu mund të zhvillohet në me shume vende me ndihmën e mjeteve te telekomunikimit, në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- që te jene te pranishëm ne te njëjtin vend, presidenti dhe sekretari i mbledhjes, nëse i emëruar, qe do të përgatisin dhe nënshkruajnë procesverbalin;
- që t'i lejohet presidentit te asamblesë të konstatojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe te shpallë rezultatet e votimit;
- që t'i lejohet personit qe mban procesverbalin të perceptojë në mënyrë të duhur ngjarjet e asamblesë që jane objekt i procesverbalit;
- që t'ju lejohet pjesëmarrësve të marrin pjesë në diskutim dhe votimin e njëkohshëm për çështjet në rendin e ditës, si dhe të shohin, marrin ose transmetojnë dokumente:



- që te tregohet ne njoftimin për mbledhjen, vendet e ndërlidhura me ndihmën e mjeteve te telekomunikacionit nen kujdesin e shoqërisë, në të cilën mund të shkojnë të pranishmit, duke e konsideruar te zhvilluar mbledhjen në vendin ku do të jenë te pranishëm presidenti dhe subjekti qe harton procesverbalin.

Neni 17

Asambleja e aksionarëve mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme sipas ligjit.

Asambleja e zakonshme eshte e kostituuar rregullisht në thirrjen e parë me pjesëmarrjen e shumë ortakëve, të cilët përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit aksionar, duke përjashtuar nga llogaritja aksionet pa të drejtë vote në po te njëjtën asamble. Ajo vendos me shumicë absolute të kapitalit të përfaqësuar në asamble.

Asambleja e zakonshme në thirrjen e dytë vendos me shumicë absolute mbi tema që duhej të ishin trajtuar në të parë, sido që të jetë pjesa e kapitalit e përfaqësuar nga ortakët që marrin pjesë.

Për vendime qe kanë lidhje me formën e organit administrativ, kërkohet votimi i favorshëm i aq shumë ortakëve që te përfaqësojnë të paktën shtatëdhjetë për qind të kapitalit aksionar.

Për vendime qe kanë lidhje me emërimin e këshillit te administrimit te shoqërisë, në mungese te shpalljes se njëzëshme, vlejné kriteret e mëposhtme: emërimet e këshilltarëve te administrimit duhet të miratohen me shumicë të thjeshtë në bazë të listave të paraqitura nga ortakët, në të cilat kandidatët do të jenë renditur në rend progresiv: secili ortak do të ketë të drejtë të votojë vetëm për një listë; më pas do t'i caktojë secilit anëtar të listës votën e marrë nga vetë lista, e ndarë më pas me një, dy dhe tre dhe ndoshta katër, pesë, sipas numrit të anëtarëve që do të zgjidhen ; do te zgjidhen ata që në çdo listë qe do të gjenden, pasi të kenë marrë kuotat më të larta, duke marrë në konsideratë për secilin kandidat që te rezultojë i përfshire në me shume lista vetëm koeficienti më të madh i arritur midis të gjithëve, duke përjashtuar kështu mundësinë e mbledhjes së koeficienteve të marra nga një kandidat ne lista te ndryshme; ne rast barazim te koeficientit për te fundit qe jane për t'u zgjedhur do te konsiderohet te zgjedhur kandidatët të vendosur në pozicionin më të lartë brenda listave përkatëse dhe ne rast se barazisë se mëtejshme do të konsiderohet i zgjedhur më i madhi ne moshe.

Në rast të dekadencës së një këshilltari administrativ nga detyra, për shkak te dorëheqjes, revokimit ose për ndonjë shkak tjetër, do të konsiderohen ne dekadence edhe te gjithë administratorët e tjere dhe procedohet me emërim i ri te të gjithë organit administrativ.

Asambleja e jashtëzakonshme, në thirrjen e parë, e kostituuar rregullisht, vendos me votimin te favorshëm të aq shumë ortakëve sa të përfaqësojnë më shumë se tetëdhjete për qind të kapitalit aksionar; në thirrjen e dytë konstituohet dhe vendos me votimin te favorshëm të aq shumë ortakëve sa te përfaqësojnë më shumë se shtatëdhjetë për qind te kapitalit aksionar.

Nëse ekzistojnë kategori te ndryshme te aksioneve vendimet e asamblesë qe prekin te drejtat e njërës prej tyre, duhet të miratohen edhe nga asambleja speciale e ortakeve e kategorisë në fjalë.

Asamblesë speciale i aplikohen dispozitat qe kane lidhje me asamblenë e jashtëzakonshme.

Asambleja e zakonshme duhet të mblidhet të paktën një herë në vit brenda 120 (njëqind e njëzet) ditë nga mbyllja e bilancit te shoqërisë dhe brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve kur e kërkojnë nevoja që kane lidhje me strukturën dhe me objektin e shoqërisë.



Neni 18

Çdo ortak që ka të drejtë të marrë pjesë në asamble mund të përfaqësohet edhe nga subjekt jo-aksionar në përputhje me nenin 2372 të Kodit Civil, me prokurë me shkrim, që duhet të mbahet nga shoqëria; ajo nuk mund të lëshohet me emrin e delegatit me të bardhë dhe gjithmonë mund të revokohet, pavarësisht ndonjë marrëveshje të kundërt.

Nëse prokura jepet vetëm për një asamble të vetme, ajo ka efekt edhe për thirrjen e dytë.

Pranohet edhe një delegim që vlen për disa asamble, pa marrë parasysh rendin e tyre të ditës.

KREU V: ADMINISTRIMI

Neni 19

Shoqëria mund të administrohet, në mënyrë alternative dhe me vendim të ortakëve pas emërimit, duke respektuar kuorumin, sipas paragrafit të katërt të nenit 17 që paraprind:

- a. nga një administrator i vetëm;
- b. nga një këshill administrimi i përbërë nga një minimum prej tre dhe maksimum prej pesë anëtarë, në baze të numrit të përcaktuar nga ortakët në momentin e emërimit;

Me organ administrativ kuptojmë administratorin e vetëm ose këshillin administrativ.

Mund të zgjidhen administratore edhe ata që nuk janë ortakë të shoqërisë. Emërimi i administratoreve i takon asamblesë së zakonshme, përveç të parëve që janë emëruar në aktin themelues.

Administratorët mund të rizgjidhen dhe qëndrojnë në detyrë për periudhën e caktuar nga asambleja që i emëron ata, në çdo rast jo më shumë se tre vite ushtrimor.

Këshilli i administrimit, nëse nuk e ka bërë këtë asambleja e ortakëve, zgjedh Presidentin nga radhët e anëtarëve të tij.

Këshilli i administrimit mbledhet në vendin e treguar në njoftimin për mbledhje, si në selinë e shoqërisë por edhe tjetërkund, me kusht që ky vend të jete në Itali, me thirrjen e presidentit, edhe me kërkesë nga ana e anëtarëve të tij ose të një auditues.

Thirrja, e cila përmban temat që do të trajtohen, behet me letër rekomande, me telegram, me telefaks ose me poste elektronike të paktën pesë ditë më parë se mbledhja dhe në raste urgjente, me telegram ose telefaks, ose poste elektronike, që dërgohet të paktën dy ditë më parë në adresën e secilit këshilltar ose auditues. Telefaksi do të dërgohet në numrin që i është komunikuar, nga administratorët dhe audituesit, shoqërisë, ose njoftimi kryhet nëpërmjet postes elektronike, në adresën e postes elektronike, që edhe treguar nga po të njëjtët.

Ky formalitet nuk është i nevojshëm nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit dhe të gjithë anëtarët efektiv të kolegjit të auditorëve.

Mbledhja drejtohet nga presidenti i këshillit të administrimit, i cili emëron një sekretar i cili harton procesverbalin e mbledhjes, që duhet të nënshkruhet nga ai dhe nga presidenti.

Vendimet e këshillit do të jenë të vlefshme kur të jenë të pranishëm shumica e këshilltarëve dhe do të merren me shumicë absolute të votave.

Në rast të barazisë së votave, propozimi për vendim do të konsiderohet i refuzuar.

